SHTOJCA NR. 6- VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 77 | 2024
Datë/Datum. 29.01.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA

Emri i institucionit: Organi Shqyrtuese i Prokurimit

Numri: 77/2024

Data: 29.01.2024

Vendi: Prishtinë

Në bazë të Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë:26.01.2024, titullari i institucionit nxjerr:

VENDIM

1. Miratohet plani i integritetit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr.1397/23, datë.26.10.2023.

2. znj. Blerina Huruglica -Eksperte Shqyrtuese , caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit *(GazetaZyrtare nr. 19, datë 21.07.2022),* në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 26.07.2023 , titullari i institucionit nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim nr.1397/23, të datës 26.10.2023, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të Vendimit.

znj./z, sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Personit përgjegjës;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.